

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
viti 2023

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	24.02.2023	Bazuar në nenin 3 dhe nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtar”, emisioni investigativ ...kërkon informacion për çështjen civile me pale ne proces shtetasen M.S, si dhe marrjen në konsideratë të kërkesës për përshpejtimin e kësaj çështje.	10.03.2023	Në përgjigje të shkresës tuaj, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, datë 24.02.2023, pas kryerjes së verifikimeve në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe tërheqjes së dosjeve të rishortuara, nga ambientet e ish - Gjykatës së Apelit Durrës ju informojmë se: Në zbatim të vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, neni 7, “Për	E plotë	Nuk ka

¹Numrarendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

			<p><i>menaxhimin e çështjeve gjyqësore</i>”, në datën 03.02.2023, janë rishortuar të gjitha çështjet civile dhe penale për të gjitha gjykatat e apeleve, të cilat nuk ishin të planifikuara më parë për gjykim. Pas këtij rishortimi çështja e sipërpërmendur i ka rënë në short relatore gjyqtares Arta Duka, e cila është edhe gjyqtarja aktuale relatore.</p> <p>Lidhur me çështjet që po gjykohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju bëjmë me dije se kanë filluar të shpallen për gjykim ato çështje, të cilat janë regjistruar në apel në vitin 2017.</p> <p>Nisur nga këto rrethana, janë planifikuar dhe janë shpallur për gjykim kryesisht çështje të karakterit penal, që lidhen me kufizimin e lirisë së personit apo çështje civile, për të cilat qytetarët kanë paraqitur kërkesa për përshejtim, kur gjyqtari relator ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqet ligjore të</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>parashikuara në ligj për pranimin e kërkesës.</p> <p>Referuar rastit konkret, rezultoi se që nga data e regjistrimit të çështjes në apel dhe deri sot, asnjë nga palët në proces nuk ka depozituar një kërkesë për përsheptimin e gjyqimit të çështjes, jashtë radhës së gjyqimit.</p> <p>Neni 460 i Kodit të Procedurës Civile, citon:</p> <p><i>2. Relatori cakton datën dhe orën e gjyqimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.</i></p> <p><i>3. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përsheptimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.”</i></p> <p>Në lidhje me sa kërkoni për përsheptim gjykimi, në bazë të vendimit nr.78, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p><i>Apelit</i>”, në Kreun III “<i>Kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, paraqitja dhe shqyrtimi i saj</i>”, janë të përcaktuara mënyra e paraqitjes dhe procedimit të kërkesës për përshpejtim gjykimi</p>		
2	06.03.2023	Vënien në dispozicion nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit Përgjithshëm, vendimin penal ndaj shtetasen me iniciale E. H.	06.03.2023	<p>Në përgjigje të kërkeses tuaj, bashkëlidhur do të gjeni vendimin e anonimizuar me të pandehur shtetasen me iniciale E.H.</p> <p>Sjellim në vëmendjen tuaj se qasja në këtë informacion duhet të trajtohet për qëllime studimore ose statistikore në respektim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” por edhe të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 15 datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemim gjyqësor”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Udhëzimit Nr. 31 datë 27.12.2012 “Për E plot e Nuk ka përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime</p>	E plotë	Nuk ka

				gazetarie, letrare dhe artistike”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Udhëzimit Nr. 9 datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, të ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale		
3	08.03.2023	Në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, kërkoj nga ana juaj, informacion dhe dokumentacion zyrtar për sa vijon: -Një kopje të njësuar me origjinalin të procedurës për zhvillimin e shortit elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtim, të dorëzuar nga z.Ervin Salianji. - Një kopje të njësuar me origjinalin të procedurës për zhvillimin e shortit elektronik për caktimin e gjyqtarit që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtim, të dorëzuar nga z.Ervin Salianji.	13.03.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se: -Në bazë të vendimit nr. 1 prot datë 01.02.2023 “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente”, të zv/Kryetares së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kërkesa penale me palë kërkuese z.Ervin Salianj, është hedhur në short elektronik dhe i ka rënë për gjykim gjyqtares Elona Mihali. -Kërkesa penale me palë kërkuese z.Jetmir Oldashi, i ka kaluar pot ë njëjtës gjyqtare	E plotë	Nuk ka

				pasi objekti i kërkimit është i njëjtë. Bashkëlidhur riv-et.		
4	13.03.2023	Referuar ligjit “Për të drejtën e informimit”, kërkohet informacion për shtetasin me iniciale F.M. -Ka marrë ndonjë vendim Gjykata e Apekit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndonjë kërkesë të tij ose palë tjetër për ndryshim mase sigurimi. - Nëse po, kërkohet vënien në dispozicion të vendimit?	13.03.2023	Në përgjigje të emailit tuaj, ju informojmë se: Për shtetasin me iniciale F.M, që nga data e Njoftimit për Media datë 31.10.2022, nuk rezulton të jetë gjykuar çështje tjetër penale në Gjykatën e Apelit. Në lidhje me vënien në dispozicion të vendimit, ai lidhet me kërkesë në fazën e hetimeve paraprake dhe të dhënat që përmban ruhen sipas ligjit nga secret hetimor.	E plotë	Nuk ka
5	24.03.2023	Referuar ligjit “Për të drejtën e informimit”, kërkohet informacion se sa kërkesa janë depozituar pranë Gjykatës së Apelit “Për trjtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, për kundërshtim të vendimeve të marra nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronës.	04.04.2023	Në përgjigje të emailit tuaj të datës 23.03.2023, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.2657 Prot., datë 24.03.2023, në lidhje me kërkesë paditë e regjistruara për gjykim, si shkallë e parë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë është palë e paditur me objekt “Kundërshtimin e vendimit të ATP-së”, për periudhën 2016-2023, ju informojmë se nga verifikimet e kryera në	E plotë	Nuk ka

				<p>Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezultojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin 2016 janë regjistruar 12 çështje; - Për vitin 2017 janë regjistruar 147 çështje; - Për vitin 2018 janë regjistruar 122 çështje; - Për vitin 2019 janë regjistruar 79 çështje; - Për vitin 2020 janë regjistruar 27 çështje; - Për vitin 2021 janë regjistruar 28 çështje; - Për vitin 2022 janë regjistruar 40 çështje; - Për vitin 2023 janë regjistruar 8 çështje; 		
6	29.03.2023	<p>Nga emisioni inestigativ,po investigohet një konflikt midis Shoqërive “<i>Ll... N...</i>” sh.p.k dhe Shoqërisë “<i>S... C....</i>” sh.p.k, redaksia vihet në dijeni nga pala e interesuar Ll.. N... sh.p.k, që përsëri çështja civile i është caktuar me short përsëri gjyqtares Ornela Naqellari. Ky shqetësim është shprehur edhe në formën e kërkuar me ligj nga vetë pala e interesuar ku kërkon përsëri përjashtimin e gjyqtares Ornela</p>	18.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email, të datës 29.03.2023, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 2940 Prot., datë 29.03.2023, nga verifikimet e kryera në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve ju informojmë:</p> <p>-Në lidhje me pyetjen “<i>Se është rastësi apo procedurë,</i></p>	E plotë	Nuk ka

		<p>Naqellari nga cështja në gjykim midis dy shoqërive. Në këto kushte bazuar në të drejtën e informimit kërkojmë:</p> <p><i>1. Se është rastësi apo procedurë, që kjo çështje (paditës Shoqëria “Ll... N...” sh.p.k dhe i paditur Shoqëria “S... C....;” sh.p.k.), i caktohet përsëri gjyqtares Ornela Naqellari?</i></p> <p><i>2. Kërkojmë një opinion institucional se si mund ti jepet një zgjidhje të kërkuar në ligj, rastit të besueshmërisë në barazi, në një gjykim të drejtë dhe transparent?</i></p>	<p><i>që kjo çështje (paditës Shoqëria “Ll... N...” sh.p.k dhe i paditur Shoqëria “S... C....;” sh.p.k.), i caktohet përsëri gjyqtares Ornela Naqellari?”, ju informojmë se në zbatim të vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, neni 7, “Për menaxhimin e çështjeve gjyqësore”, në bazë të shortit elektronik të datës 03.02.2023, i bërë publik dhe në prani të gazetarve, janë rishortuar të gjitha çështjet civile dhe penale, të të gjitha gjykatave të apeleve, të cilat nuk ishin të planifikuara më parë për gjykim. Pas këtij rishortimi çështja civile me palë paditës Shoqëria “Ll.... N....” sh.p.k dhe i paditur Shoqëria “S.... C....” sh.p.k i ka rënë në short relatore gjyqtares Ornela Naqellari, (bashkëlidhur Riv-in nga Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve.</i></p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>-Në lidhje me pyetjen “Kërkojmë një opinion institucionale se si mund ti jepet një zgjidhje të kërkuar në ligj, rastit të besueshmërisë në barazi, në një gjykim të drejtë dhe transparent?”, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju bën me dije se janë rregullat e caktuara me ligj, sipas të cilave caktimi i gjyqtarit të çështjes bëhet nëpërmjet shortit dhe zëvendësimi i tij kryhet sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.</p>		
7	13.04.2023	<p>Në kuadër të të drejtës së informimit dhe të viktimës kërkojmë: 1. Se në çfarë date është rregjistruar në Gjykatën e Apelit, çështja penale me palë kërkues Pokuroria Tiranë, me të pandehur M.T dhe viktima G. A dhe se kujt gjyqtari i është caktuar me short kjo çështje dhe data e caktimit? 2. Përse nuk ka dalë akoma për gjykim kjo çështje dhe arsyen?</p>	24.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email, të datës 12.04.2023, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 3781 Prot., datë 13.04.2023, nga verifikimet e kryera në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve, ju informojmë: -Në lidhje me dy pyetjet e para “Se në çfarë date është rregjistruar në Gjykatën e Apelit, çështja penale me palë kërkues Pokuroria Tiranë, me të pandehur M.T dhe viktima</p>	E Plotë	Nuk ka

				<p><i>G.A dhe se kujt gjyqtari i është caktuar me short kjo çështje dhe data e caktimit ?”, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton se çështja penale me palë në proces: Kërkuar Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e pandehur M. T dhe viktima G.A, me objekt: <i>Kryerjen e veprës penale "Ndotja e ajrit; hedhja ose braktisja e shiringave" "Goditje për shkak të detyrës", parashikuar nga nenet 201, 237, 285/b të Kodit Penal,</i> është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë, më datë 10.12.2018. Në zbatim të vendimit nr.505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, neni 7, “Për menaxhimin e çështjeve gjyqësore”, në bazë të shortit elektronik të datës 03.02.2023, janë rishortuar të gjitha çështjet civile dhe penale, të të gjitha gjykatave</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>të apeleve, të cilat nuk ishin të planifikuara më parë për gjykim. Pas këtij rishortimi çështja e sipërpërmendur i ka rënë në short relatore gjyqtares Vojsava Osmanaj, e cila është edhe gjyqtarja aktuale relatore (<i>bashkëlidhur Riv-in nga Sistemi Informatik i Menaxhimit te Çështjeve</i>).</p> <p>-Në lidhje me pyetjen “Përse nuk ka dalë akoma për gjykim kjo çështje dhe arsyen?”, ju bëjmë me dije se lidhur me çështjet që po gjykohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndiqet dhe respektohet rradha e gjykimit të çështjeve sipas regjistrimit të tyre, si dhe nga gjyqtarja Vojsava Osmanaj po gjykohen afërsisht 134 çështjet penale, të cilat janë regjistruar në apel para çështjes së mësipërme, si dhe po gjykohen çështjet me karakter të ngutshëm sipas ligjit</p>		
8	25.04.2023	<p>Në vijim të komunikimit ne lidhje me kerkesen qe i jam drejtuar Gjykates se Apelit, së viktimë kërkojm informacioni si më poshtë:.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kujt gjyqtari i eshte caktuar me short kjo ceshtje ne 2018? 2. Pse nuk eshte gjykuar akoma 	24.05.2023	<p>Në vijim të komunikimeve, dhe në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email, të datës 25.04.2023, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,</p>	E Plotë	Nuk ka

		<p>kjo ceshtje nga gjyqtari qe i eshte caktuar?</p> <p>3. A ka gjykuar ,gjyqtari,Genti Shala ceshtje te tjera te cilat kane te njejtin date dhe vit me ceshtjen ku viktime eshte G.A?</p> <p>4. Nqs po,na vini ne dispozicion specifiken e ceshtjeve qe jane gjykuar jashte rradhe nga gjyqtari,Genti Shala</p>		<p>nr. 4459 Prot., datë 25.04.2023, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju ribën me dije se:</p> <p>-Në lidhje me pyetjen e parë “<i>Se kujt gjyqtari i është caktuar me short kjo çështje në vitin 2018?</i>”, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton se çështja penale me palë në proces: Kërkuës Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e pandehur M. T dhe viktima G.A, me objekt: <i>Kryerjen e veprave penale të "Ndotjes së ajrit; hedhjes ose braktisjes së shiringave", "Goditje për shkak të detyrës", parashikuar nga nenet 201, 237, 285/b të Kodit Penal</i>, është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë, më datë 10.12.2018, në bazë të shortit elektronik datë 11.12.2018 çështja i ka rënë relator gjyqtar Genti Shala. Në zbatim të vendimit nr.505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “<i>Për fillimin e</i></p>		
--	--	---	--	--	--	--

			<p><i>funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, neni 7, “Për menaxhimin e çështjeve gjyqësore”, në bazë të shortit elektronik të datës 03.02.2023, janë rishortuar të gjitha çështjet civile dhe penale, të të gjitha gjykatave të apeleve, të cilat nuk ishin të planifikuara më parë për gjykim. Pas këtij rishortimi çështja e sipërpërmendur i ka rënë në short relatore gjyqtares Vojsava Osmanaj, e cila është edhe gjyqtarja aktuale relatore (<i>bashkëlidhur Riv-in nga Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve</i>).</i></p> <p>-Në lidhje me pyetjet dy, tre dhe katër “<i>Pse nuk është gjykuar akoma kjo çështje nga gjyqtari që i është caktuar? A ka gjykuar gjyqtari Genti Shala çështje të tjera të cilat kanë të njëjtën datë dhe vit me çështjen ku viktimë është G.A? Në qoftë se po na vini në dispozicion specifikën e çështjeve që janë gjykuar jashtë rradhe nga gjyqtari Genti Shala? ”, ju bëjmë me</i></p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>dije se lidhur me çështjet që janë gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe që po gjykohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndiqet dhe respektohet rradha e gjykimit të çështjeve sipas regjistrimit të tyre. Për shkak të zbatimit të procesit të rivlerësimit kalimtar Vettingut, të dorëheqjeve të gjyqtarëve, si dhe të daljes në pension të tyre, numri i gjyqtarëve vijoi të pakësohet për disa vite rresht. Evidentohet se për gati një vit, Gjykata e Apelit Tiranë e kreu funksionin me vetëm gjashtë gjyqtarë, nga tridhjetenjë që ka pasur në organikën e kësaj gjykate. Është për tu theksuar fakti se me largimin e këtyre gjyqtarëve, çështjet janë rihedhur disa herë në short, gjë që ka sjellë gjykimin e çështjeve me datë regjistrimi më të hershme. Gjithashtu, ju informojmë se Gjykata e Apelit Tiranë, ka qënë në pamundësi për të ndarë gjyqtarët në dhoma (penale</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				dhe civile), ndaj të gjithë gjyqtarët kanë qënë të angazhuar krahas çështjeve civile, edhe me gjykimin e atyre penale. Kjo situatë ka sjellë edhe vonesë në gjykim, përfshirë këtu edhe çështjen tuaj. Nisur nga këto rrethana, dhe nga verifikimi i listave të gjykimit të gjyqtar z.Genti Shala që prej vitit 2018 e në vazhdim, janë planifikuar dhe janë shpallur për gjykim kryesisht çështje të karakterit të ngutshëm, që lidhen me kufizimin e lirisë së personit, masat e sigurimit apo çështje civile, për të cilat qytetarët kanë paraqitur kërkesa për përsheptim, kur gjyqtari relator ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në ligj si dhe në vendimin e KLGJ-së nr. 78 datë 30.05.2019, për pranimin e kërkesës.		
9	15.05.2023	1.Lidhur me hetimin e nisur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, regjistruar përmes procedimit penal nr., datë 13.07.2017, për veprat penale të	17.05.2023	Në përgjigje të kërkesave tuaja dërguar me email, protokolluar pranë Gjykatës së apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm përkatësisht me	Refuzuar	Nuk ka

	<p>parashikuara nga nenet 190/2, 144-25, 248,190/3-25, dërguar për gjykim më 21.04.2020, me 11 të pandehur, përkatësisht shtetasit: E.M., akuzuar për veprën penale sipas nenit 186/3, shtetasi T. B., akuzuar për veprën penale sipas nenit 186/1, shtetasi Y. B., akuzuar për veprën penale sipas neneve 190/2, 144-25, 144-22, shtetasi B. B., akuzuar për veprën penale sipas neneve 144-25, shtetasi R. H., akuzuar për veprën penale sipas nenit 144-25, shtetasi K. Gj., akuzuar për veprën penale sipas neneve 190/3-25, shtetasi Y. D., akuzuar për veprën penale sipas nenit 190/3-25, shtetasi E. P., akuzuar për veprën penale sipas nenit 190/3, shtetasi S. P., akuzuar për veprën penale sipas nenit 190/3-25, shtetasi B. L., akuzuar për veprën penale sipas nenit 190/3-25 dhe shtetasi E. B., akuzuar për veprën penale sipas nenit 190/3-25. Nga 11 të pandehurit, 6 prej tyre janë zyrtarë të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - AZHBR.</p> <p>Lidhur me këtë kërkoj nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (për ish- Gjykatën e Apelit Durrës):</p> <p>1. Më vendosni në dispozicion çdo vendim që mund të jetë marrë lidhur me këtë hetim pas vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan që mund të jenë apeluar nga palët. Kjo kërkesë dhe hartimi i saj bazohet në “Ligjin për të Drejtën e Informimit”, rrjedhimisht sqarojmë se pritja për një</p>		<p>nr. 5890 dhe nr. 5891 Prot., datë 15.05.2023, Ju informojmë se të dhënat që ju referoni (numri i procedimit penal) nuk korrespondojnë me informacionin që gjeneron Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, por korespondon me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve të Prokurorisë.</p> <p>Për rrjedhojë nuk mund të identifikohen dekommentat që ju kërkoni nga kjo gjykatë.</p>		
--	--	--	--	--	--

		<p>përgjigje nga institucioni juaj është 10 ditë, nëse ajo nuk kthehet, do t'i drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit.</p> <p>2.Lidhur me hetimin e nisur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e materialit të ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për të cilën Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr....., të vitit 2022, për veprat penale "Falsifikimi i dokumentave" dhe "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 i Kodit Penal. Lidhur me këtë kërkoj nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (për ish-Gjykatën e Apelit Tiranë): 1. Më vendosni në dispozicion çdo vendim që mund të jetë marrë lidhur me këtë hetim pas vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që mund të jenë apeluar nga palët.</p>				
10	18.05.2023	<p>Bazuar në ligjin për të drejtën e informimit, lutemi të na vini në dispozicion informacionin e mëposhtëm: A është dënuar ndonjëherë z. N.P., lindur në Tepelenë. Nëse po, për cilën/cilat vepra penale?</p>	29.05.2023	Në përgjigje të shkresës Tuaj, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.6142 Prot., datë 18.05.2023, ju informojmë se bazuar në	Refuzuar	Nuk ka

		Apo ky shtetas është aktualisht nën hetim për ndonjë veprë?		<i>Konventën e të Drejtave të Njeriut (neni 8), Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (neni 6), infomacioni i kërkuar mund të jepet vetëm me autorizim/pëlqim të shtetasit N. P.</i>		
11	16.06.2023	<p>Jam i interesuar të informohem nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm: në lidhje me një çështje. Në këtë Gjykatë që në mars të vitit 2021 është regjistruar kërkesa penale me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të akuzuar L.Q dhe viktimë e veprës penale shtetasi B. T., me objekt pushimin e procedimit penal. Me sa jemi informuar nëpërmjet shortit kjo çështje i ka kaluar për relativim gjyqtarit Fuat Vjerdha.</p> <p>Brenda mundësive dua të informohem se përse nuk është caktuar ende një datë për shqyrtimin e kësaj kërkesë? Sipas nenit 329/7 të K.Pr.Penale Gjykata e apelit duhet ta kishte shqyrtuar ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve. Kjo është një çështje me shkaqe të rënda dhe të motivuara për tu trajtuar me përshpejtim nga ana e Gjykatës së Apelit.</p>	27.06.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju informonë se:</p> <p>- Nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar çështja penale datë 29.03.2021 regjistrimi, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, palë e interesuar L. Q., viktima B. T., me objekt: Pushimi i çështjes. Në zbatim të vendimit nr.505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, neni 7, “Për menaxhimin e çështjeve gjyqësore”, në bazë të shortit</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>elektronik të datës 03.02.2023, janë rishortuar të gjitha çështjet civile dhe penale, të të gjitha gjykatave të apeleve, të cilat nuk ishin të planifikuara më parë për gjykim. Pas këtij rishortimi çështja e sipërpërmendur i ka rënë në short relator gjyqtar Fuat Vjerdha, i cili është edhe gjyqtari aktuale relator (<i>bashkëlidhur Riv-in nga Sistemi Informatik i Menaxhimit të Cështjeve</i>).</p> <p>Ju bëjmë me dije se lidhur me çështjet që janë gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, është ndjekur dhe respektuar rradha e gjykimit të çështjeve sipas regjistrimit të tyre. Për shkak të zbatimit të procesit të rivlerësimit kalimtar Vettingut, të dorëheqjeve të gjyqtarëve, si dhe të daljes në pension të tyre, numri i gjyqtarëve vijoi të pakësohet për disa vite rresht. Evidentohet se për gati një vit, Gjykata e Apelit Tiranë e kreu funksionin me vetëm gjashtë gjyqtarë, nga tridhjetenjë që ka pasur në organikën e kësaj</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>gjkate. Gjithashtu, ju informojmë se Gjykata e Apelit Tiranë, ka qënë në pamundësi për të ndarë gjyqtarët në dhoma (penale dhe civile), ndaj të gjithë gjyqtarët kanë qënë të angazhuar krahas çështjeve civile, edhe me gjykimin e atyre penale. Kjo situatë ka sjellë edhe vonesë në gjykim, përfshirë këtu edhe çështjen e sipërcituar. Nisur nga këto rrethana, janë planifikuar dhe janë shpallur për gjykim kryesisht çështje të karakterit të ngutshëm, që lidhen me kufizimin e lirisë së personit, masat e sigurimit apo çështje civile, për të cilat qytetarët kanë paraqitur kërkesa për përshpejtim, kur gjyqtari relator ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në ligj për pranimin e kërkesës.</p> <p>Lidhur me çështjet që po gjykohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndiqet dhe respektohet rradha e gjykimit të çështjeve sipas regjistrimit</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>të tyre. Gjyqtari Relator Fuat Vjerdha po gjykon çështjet e regjistruara në vitin 2018.</p> <p>Në lidhje me sa kërkoni për përshpejtim gjykimi, në bazë të vendimit nr.78, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, në Kreun III “Kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, paraqitja dhe shqyrtimi i saj”, janë të përcaktuara mënyra e paraqitjes dhe procedimit të kërkesës për përshpejtim gjykimi.</p>		
12	21.06.2023	<p>Emisioni investigativ ne nentor 2018 ka publikuar kete rast Per kete arsyje bazuar mbi te drejten e informimit kerkojme nga Gjykata e Apelit Tirane: Kur do behet shpallja e vendimit me pale:</p> <p>Paditese: E. Gj.</p> <p>Te paditur: Ministria e Mbrojtjes-Agjensia e Inteligjences dhe Sigurise se Mbrojtjes me relatores Elona Mihali.</p> <p>Cilat jane arsyjet e shtyrjes dy here te shpalles se ketij gjykimi.</p>	23.06.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email, të datës 21.06.2023, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 8696 Prot., datë 21.06.2023, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju informojmë se:</p> <p>- Nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar çështja civile me</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>nr. sistemi, nr. ... Akti, datë 01.10.2018 regjistrimi, me palë në proces: aditëse E. Gj., të paditur Ministria e Mbrojtjes dhe Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,</p> <p>Në lidhje me pyetjen “<i>Se cilat janë arsyet e shtyrjes dy herë të shpalljes së këtij gjykimi?</i>”, referuar proces verbaleve të seancave gjyqësore, respektivisht datë 31.05.2023 dhe 19.06.2023, rezulton se:</p> <p>Me datë 31.05.2023 ora 13:38 ka filluar seancën gjyqësore për këtë çështje. Në këtë seancë është proceduar me vijimin e hetimit gjyqësor të riçelur pranë Gjykatës së Apelit në lidhje me këtë çështje dhe janë diskutuar provat e reja të paraqitura nga pala e paditur. Pas diskutimit mbi provat, gjykata është terhequr në dhomë këshillimi dhe në kthim ka vendosur për provat që do të administrohen në këtë gjykim dhe ka deklaruar të mbyllur hetimin gjyqësor. Janë ftuar palët për pretendime përfundimtare dhe</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>për shkak të pamjaftueshmërisë së kohës, ora 14:53 dhe të gjytimeve të tjera pasuese të planifikuara po në atë date nga anëtarët e trupës gjyqesore, është vendosur që shpallja e vendimit përfundimtar të realizohet me datë 19.06.2023, ora 14:30.</p> <p>Seanca e datës 19.06.2023 ka filluar me terheqjen e trupës gjyqesore në dhomë këshillimi rreth orës 15:30 për shpalljen e vendimit përfundimtar. Trupa gjyqesore është kthyer nga dhoma e këshillimit në orën 17:24 dhe ka çelur seancën. I pranishëm në seancë ka qënë vetëm përfaqësuesi ligjor i palës paditëse E. Gj. Gjykata ka njoftuar se seanca është zhvilluar me vonesë për shkak të disa seancave gjyqësore që zgjatën tej afatit të planifikuar nga ana e anëtarëve të trupës gjyqesore si dhe për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi. Gjykata në seancë ka relatuar se duhej ende kohë për të konkluduar</p>		
--	--	--	---	--	--

				përfundimisht në zgjidhjen e çështjes dhe ka vendosur të vijojë diskutimin në dhomë këshillimi, duke e shtyrë shpalljen e vendimit përfundimtar për me datë 27.06.2023, ora 11:00 sipas kalendarit dhe ngarkesës së çështjeve në shqyrtim.		
13	12.06.2023	<p>Në kuadër të të drejtës së informimit, kërkohet të na vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:</p> <p>1.Sa është numri i çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë për periudhën shkurt-qeshor, duke filluar nga viti 2018. Përgjigjia të jepet e ndarë për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.</p> <p>2.Sa gjyqtarë kanë ushtruar funksionin pranë kësaj gjykate për këto periudha?sa ka qënë numri i gjyqëtarëve që ka përcaktuar organika për këtë periudhë?</p> <p>3.Sa është numri i çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për periudhën Shkurt-Qeshor 2023?</p> <p>4.Sa gjyqtarë ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate gjatë kësaj periudhe? Sa ka qënë numri maksimal i gjyqëtarëve që ka përcaktuar organika për këtë periudhë?</p>	05.07.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës, ju bëjmë më dije se:</p> <p>Në lidhje me pyetjen e parë, ju informojmë se:</p> <p>-Për vitin 2018 nga periudha shkurt – qeshor, janë gjykuar gjithësej 3712 çështje;</p> <p>-Për vitin 2019 nga periudha shkurt – qeshor, janë gjykuar gjithësej 2299 çështje;.</p> <p>-Për vitin 2020 nga periudha shkurt – qeshor, janë gjykuar gjithësej 887 çështje;.</p> <p>-Për vitin 2021 nga periudha shkurt – qeshor, janë gjykuar gjithësej 1139 çështje;.</p> <p>-Për vitin 2022 nga periudha shkurt – qeshor, janë gjykuar gjithësej 1338 çështje;</p> <p>Në lidhje me pyetjen e dytë, ju informojmë se:</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>-Për vitin 2018 kanë ushtruar funksionin 28 gjyqtarë; -Për vitin 2019 kanë ushtruar funksionin 18 gjyqtarë; -Për vitin 2020 kanë ushtruar funksionin 12 gjyqtarë; -Për vitin 2021 kanë ushtruar funksionin 6 gjyqtarë; -Për vitin 2022 kanë ushtruar funksionin 12 gjyqtarë; Për periudhën nga viti 2018 – 2022 organika e Gjykatës së Apelit Tiranë përbëhet nga 31 gjyqtarë.</p> <p>Në lidhje me pyetjen e tretë, ju informojmë: -Për periudhën nga 1 shkurti – 30 Qeshor janë gjykuar gjithësej 3552 çështje.</p> <p>Në lidhje me pyetjen e katërt, ju informojmë: Në zbatim të vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, aktualisht ushtrojnë funksionin pranë kësaj gjykate 24 gjyqtarë. Organika e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të</p>		
--	--	--	---	--	--

				Përgjithshëm Tiranë përbëhet nga 78 gjyqtarë.		
14	12.09.2023	<p>Bazuar në ligjin .nr.119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3, kërkojmë të informohemi dhe të na vendosen në dispozicion kopje e të dokumenteve të mëposhtme:</p> <p>1-Lista e emrave të gjithë të punësuarve pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, konkretisht ata që janë të emëruar në pozicione këshilltarësh; kancelar/e: sekretar/e gjyqësorë; në pozicione të të gjithë kategorive që kërkojnë statusin e nëpunësit civil; si dhe në pozicione bazuar në Kodin e Punës - ku të përcaktohen data e punësimit, arsimimi dhe pozicioni i secilit.</p>	22.09.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion ardhur në adresë elektronike të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.</p> <p>Bashkëngjitur, Ju dërgojmë informacioni e kërkuar.</p>	E plotë	Nuk ka
15	21.09.2023	<p>Për t’i ardhur në ndihmë informacionit të saktë publik, në bazë të ligjit nr. 119/2014 neni 15 pika 1 dhe 2 (Për të Drejtën e Informimit); Redaksia, kërkon vendimin e apelit per lirimin e E. S.</p>	21.09.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj Bashkëngjitur, Ju dërgojmë informacioni e kërkuar për të pandehurin E.S.</p>	E plotë	Nuk ka
16	23.10.2023	<p>Vënien në dispozicion nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit Përgjithshëm, vendimin penal ndaj shtetasit me iniciale Dh. A. B.</p>	03.11.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, bashkëlidhur vendimin penal ndaj të pandehurit me iniciale Dh. A. B.</p>	E plotë	Nuk ka

17	27.10.2023	<p>Në kuadër të të drejtës së informimit, kërkohet të na vihet në dispozicion informacioni në lidhje me ecurinë e gjyqimit të procedimit penal të vitit 2019, që ka lidhje me përgjegjësit për ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019. Kam interes të di se ku ndodhet ku proces gjykimi në Gjykatën e Apelit.</p>	09.11.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion në lidhje me ecurinë e gjyqimit të procedimit penal të vitit 2019 që ka lidhje me përgjegjësit për ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, ju informojmë se:</p> <p>-Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezultojnë e regjistruar çështja penale me palë në proces: Palë e interesuar Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, A. L, Sh. L, B. L, M. M, B. B, M. R, F. Gj dhe të pandehur N.I, A. D, A. T, A. Ç, F. Gj, A. Q, S. B, akuzuar: <i>Për kryerjen e veprave penale të "Shpërdorimi i detyrës" dhe "Falsifikimi i dokumentave", parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal, është regjistruar në Gjykatën e Apelit Durrës, më datë 09.01.2023, me nr. 12 Akti. Në zbatim të vendimit nr.505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", neni 7, "Për menaxhimin e çështjeve gjyqësore", në bazë të shortit elektronik, janë rishortuar të</i></p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

				gjitha çështjet civile dhe penale, të të gjitha gjykatave të apeleve, të cilat nuk ishin të planifikuara më parë për gjykim. Pas këtij rishortimi çështja e sipërpërmendur i ka rënë në short relatore gjyqtares Emona Muçi dhe është në pritje të planifikimit.		
18	06.11.2023	Bazuar në ligjin .nr.119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkojmë vënien në dispozicion nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit Përgjithshëm, vendimin civil me paditës Xh.B	13.11.2013	Në përgjigje të kërkeses tuaj, bashkëlidhur vendimin civil të anonimizuar me paditës Xh.B.	E Plotë	Nuk ka

¹Numri i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

¹Data e regjistrimit të kërkesës

¹Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve të ligjore në fuqi

¹Data e kthimit të përgjigjes

¹Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve të ligjore në fuqi

¹Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

¹Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.